





Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.37/350-58922 datë: 27.01.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350-58922 datë: 10.12.2020
PËR/TO:	"Graniti" Sh.p.k, përfaqësues i kompanisë Granit Lumi, rruga "Ibrahim Rugova" - Shirokë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI REXHEPAJ Punoi: Sedat Bytyçi, inxh.dip.ndërt.
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-58922 datë: 10.12.2020 nga Granit Lumi, "Graniti" Sh.p.k nga Suhareka, për Leje Ndërtimore për objektin afarist-depo e materialeve, me etazhitet P+0 dhe P+1, në parcelën kadastrale 2785-25, me numër referues të certifikatës 5146/2020 datë 27.11.2020, P.Sh e Komunës së Suharekës e në shfrytëzim të "Graniti" Sh.p.k Suharekë me seli në Shirokë Rr.Ibrahim Rugova dhe "Euro--Besi" Sh.p.k me seli në Prishtinë Rr.Muharrem Fejza, të cilat i përfaqëson Granit Lumi nga Suhareka, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

• **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**





Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 27.01.2021

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.37/350-58922

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe LPA, Nr. 02/L-28, të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01Nr.16-423 datë 26.01.2011, si dhe sipas Planit Rregullues Urban Zona Industriale në Shirokë 01Nr.10074 datë 21.04.09, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga **Granit Lumi** nga Suhareka, DUP lëshon këtë:

AKTVENDIM
MBI LEJEN NDËRTIMORE

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Granit Lumi përfaqësues i kompanisë " Graniti" Shpk	Nr. Personal:	
Adresa:	Rr. " Ibrahim Rugova"- Shirokë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore 07Nr.350-58922 datë 10.12.2020

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI			
Adresa: Rruga "Ukë Bytyqi" në Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:		Përpjesa:
Me numër referues 5146/2020 të datës 27.11.2020, Zona Kadastrale Suharekë	02785-25, Parcela ndërtimore P-58, T11		1 : 1000

Lloji i ndërtimit të propozuar: Depo e materialeve			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Ndërtim i Ri - Kategoria II			
Gabariti	70.0m'x30.0 m' dhe 12m'x20m'	Katshmëria	P+0 dhe P+1
Sipërfaqe totale bruto		2580 m ²	
Vija rregullative	Nga mesi i Rruges B-B 5.5m'	Vija ndërtimore	Të jetë 15m' nga vija rregullative, ndërsa nga parcelat fqinjë objekti të largohet min.5m'.

Përshkrimi:

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore "Graniti" Sh.p.k me përfaqësues Granit Lumi nga Suhareka i lejohet ndërtimi i objektit me destinim Depo e materialeve me etazhitet P+0 dhe administratë P+1.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PRrU të Zonës Industriale në Shirokë 01Nr.10074 datë 21.04.2009, ku sipas gjendjes se planifikuar parcela kadastrale është me destinim Depo e materialeve.

Objekti ka karakter të përhershëm, me etazhitet P+0 depo e materialeve dhe P+1 administrata. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Njoftimit rreth Kushteve të caktuara nga ky organ 07Nr.460/350-46695 datë 10.11.2020.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e aprovimit, përveç nëse zgjatet afati. Duhet të siguroheni se kontraktuesi i posedon në vendndërtim dokumentet e mëposhtme:

-Një kopje të kësaj leje ndërtimore.

-Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktorit.

-Së paku një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.

Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit:

Libri dhe ditari i ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe fotografike, që dokumentojnë:

Datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore dhe përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.

Duhet të njoftohet Drejtoria e Inspeksionit për datën e fillimit të punimeve së paku 7 ditë para.

Duhet të kontaktoni organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe arkitektin ose inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportoj në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore me udhëzime të inspektoratit komunal.

Pas përfundimit të punëve ndërtimore, duhet të aplikoni për pranim teknik, certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe Kodin.

Arsyetim

Granit Lumi nga Suhareka përfaqësues i "Graniti" Sh.p.k, me kërkesën 07Nr.350-58922 datë 10.12.2020 ka kërkuar leje ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Depo e materialeve. Bashkë me kërkesën pala ka ofruar dokumentacionin në fjalë:

- Kopjen e planit dhe Çertifikatën e pronësisë.
- Vertetimin e tatimit në pronë.
- Fotokopjen e leternjoftimit
- Pëlqim me kushte për rregullim të dokumentacionit teknik nga KEDS Nr.1437 datë 04.12.2020.
- Pëlqim për kyçe në rrjetin Publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit Nr.129 datë 26.11.2020, lëshuar nga Kompania Regjionale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit "Hidroregjioni Jugor" sh.a. Prizren.
- Pëlqim për mbeturina Nr.prot. 173/2020 datë 27.11.2020 lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI".
- Pëlqim për kyçe në komunikacion nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.2065 datë 17.11.2020.
- Pëlqim sanitar nga Inspektori Sanitar 09Nr.2067 datë 18.11.2020
- Pëlqimin e Mbrojtës nga Zjarri Nr.03/03-101 datë 02.12.2020 lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë, Komuna Suharekë.
- Lejen Mjedisore Komunale 03Nr.590/181-58404 te datës 28.12.2020 lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë, Komuna Suharekë.
- Elaborat Gjeomekanik, nga N.SH. "Test & Ing" Prizren, Tetor 2020
- Sipas Njoftimit 07Nr.561/350-58922 datë 28.12.2020 parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 7224.00€ dhe se për pagesën e kryer janë sjellë dëshmia lëshuar nga Raiffesen Bank Kosovo J.S.C me datë 22.01.2021, sipas faturës komunale nr.0000373 të datës 28.12.2020.
- Pëlqim nga bashkëshfrytëzuesi i parcelës "Euro-Besi" shpk Prishtinë LRP nr.7992//2020.
- Njoftimit rreth Kushteve ndërtimore 07Nr.460/350-46695 datë 10.11.2020 (kopje).
- Kontratë për dhënjë në shfrytëzim të pronës së Komunës 01-Nr-016-32539, datë 18.08.2020(ko). Ky organ përmes shërbimit të vetë profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse si dhe konform PRrU "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009 dhe Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve 01Nr.16-423 datë 26.01.11, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme dhe se investitorit mund ti jepet Leja për ndërtimin e objektit të cituar.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje ndërtimore mund ti paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim


Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.37/350-58922 datë 27.01.2021

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës,
- Dosjes së DUP-së

Faqe 3 nga 3

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, Nr.026, Suharekë
Telefon: 029 271 313
www.komuna-suhareke.org, E-mail: komuna@suhareke.org



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
Samir KUPI REXHEPAJ

